


7 maj 2025

Rajoni i Euroazisë



Spanja

Gjatë mijëra viteve, shumë grupe të ndryshme njerëzish u zhvendosën në atë që sot është Spanja, duke kontribuar në kulturën e saj të larmishme. Për dy shekuj (16të dhe 17të), perandoria e fuqishme e Spanjës u zgjerua me forcën detare që mbështeti eksplorimin e saj të Botës së Re, duke sjellë një thesar të madh në arkat e saj. Ky pushtet u zbeh gjatë shekujve dhe ndryshimet e pushtetit ishin të shpeshta. Spanja arriti të qëndronte neutrale gjatë të dy Luftërave Botërore. Nga viti 1936-1939, ajo u copëtua nga lufta civile, e cila rezultoi në një diktaturë. Pas vdekjes së diktatorit, Spanja kaloi në një demokraci dhe përjetoi rritje të shpejtë ekonomike dhe modernizim. Në vitin 1986, Spanja u bashkua me Bashkimin Evropian (BE) dhe ka vazhduar të përparojë, ekonomia e katërt më e madhe e euro-zonës. Kisha e Nazaretasit vendosi punën atje në vitin 1981, shpesh duke marrë me qira objekte për shërbesën dhe misionin. Megjithatë, vitet e fundit, është bërë e domosdoshme që kishat të sigurojnë ndërtesa të pavarura që lehtësojnë shërbimin e vazhdueshëm në komunitete. Kjo është një histori e një prej atyre tranzicioneve në qytetin dinamik të Zaragozës.



416 Anëtarë



9 Kisha Plotësisht
të Organizuara



9 Shërbëtorë të Liçensuar,
dhe 4 Shërbëtorë të
Shuguruar në 1 Distrikt

LUTJE



- Lutuni për punën në rritje të Kishës së Nazaretasit në Zaragoza, Spanjë dhe për ata që i shërbejnë komunitetit të tyre nëpërmjet këtij kongregacioni.
- Lutuni për grupet e shumta të shtëpive dhe Shkollat e së Dielës që po krijohen nga ky kongregacion i ri.

LAVDËRIM



- Lavdëroni Perëndinë për lutjen e përgjigjur për një ndërtesë kisha në Zaragoza dhe për Ekipin e Misioneve që u bashkua me kongregacionin për ta bërë ndërtesën gati për shërbesat.
- Lavdëroni Zotin për ndikimin e ri dhe angazhimin në rritje me komunitetin në Zaragoza, për shkak të dhurimit besnik të Nazaretasve nëpërmjet Ofertës Alabastër dhe Fondit të Ungjillizimit Botëror.




Kaleidoskopi për Fëmijë

Kliko [këtu](#) për të aksesuar në Kaleidoskopin për Fëmijë, një shtesë mujore në MNN Qendrore për të zgjuar dhe ushqyer një frymë misionesh tek të gjithë.

Një Shikim i Shpejtë MNN



Gjatë 75-vjetorit të Alabasterit, u nda një histori në lidhje me nevojën për ndërtesa të pavarura kishash në Spanjë. Veçoria e videos shpjegoi nevojën kritike dhe u bëri thirrje Nazaretasve që të luteshin dhe të jepnin në mënyrë që pronat të mund të siguroheshin dhe kongregacionet të mund të lëviznin në hapësira të sigurta për adhurim dhe shërbim. Për të parë këtë video, klikoni [ketu](#).



Lutjet kanë marrë përgjigje dhe Perëndia po e bekon me bollëk kongregacionin në Zaragoza, Spanjë, me një ndërtesë të re dhe mundësi të reja për t'i shërbyer hirit dhe dashurisë së Tij në atë qytet. Kisha ndodhet në një nga zonat më të varfra të qytetit dhe punon mes familjeve me të ardhura të ulëta. Kisha po eksploron bashkëpunimin me Kryqin e Kuq për të shpërndarë ushqime për personat në nevojë dhe familjet në lagjet e privuara brenda qytetit.

Kjo blerje prone u bë e mundur përmes Fondit Alabastër dhe nëpërmjet bujarisë së Kolegjit Olathe të Kishës së Nazaretasit. Prishja dhe rindërtimi i pjesës së brendshme nga një dyqan saldimi në një hapësirë adhurimi u bë i mundur me ndihmën e një ekipi të misioneve nga Michigani. Ekipet e misioneve përbëhen nga Nazaretas që shkojnë dhe shërbejnë në projekte specifike; ata punojnë nëpër rrethe në vendin e tyre ose udhëtojnë ndërkombëtarisht për të ndihmuar kongregacionet lokale në transformimin e hapësirave për shërbesë dhe misione. Në këto udhëtime ndërkulturore, anëtarët e ekipit shohin drejtpërdrejt se si Perëndia po lëviz nëpër botë dhe ata përjetojnë adhurim me vëllezërit dhe motrat në Krishtin.

Ekipi i Misioneve nga Michigan që erdhi për të ndihmuar në Zaragoza, Spanjë, përbëhej nga 10 individë që dhanë kohën, energjinë dhe shërbesën e tyre të dhembshurisë për të parë dyqanin e vjetër të saldimit të transformuar në një hapësirë adhurimi dhe shërbesash. Kjo ofroi mundësi për ekipin e Michiganit të përjetonte Spanjën dhe kulturën unike të kishës, një përzierje kulturore e shumë njerëzve që vinin nga Amerika e Jugut për t'u bashkuar me besimtarët vendas. Së bashku, ata shijuan ushqime të veçanta tradicionale, si 'arroz con pollo' (pulë në oriz dhe perime) dhe ndanë dëshmi se si po punon Zoti në jetën e tyre, si në Michigan ashtu edhe në Zaragoza. Këta Nazaretas ishin në gjendje ta shihnin Perëndinë të pasqyruar në mënyra të reja përmes syve të kulturave të ndryshme.



Ka shumë për të festuar në Zaragoza, pasi është raportuar për përparime në komunitet, me mbi 20 vizitorë të rinj që kanë ardhur në kishë javët e fundit.

*Historia origjinale në Buletinin e Mesdheut Perëndimor Nëntor 2024.

Për më shumë informacion rreth Ekipeve të Misioneve Nazaretase klik [ketu](#).

[A mund të shërbeni?](#)

A ju thërret Zoti që të shërbeni në Rajonin e Eurazisë?

Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF.

Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).



17001 Prairie Star Pkwy
Lenexa, KS | 66220 US



KISHA e
NAZARENIT